



Prishtinë, 22 prill 2026
Kodi i ZRRE-së: V_3148_2026

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Mbështetur në Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, paragrafi 3 dhe 4, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, dhe Nenit 51 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084); Nenit 3 paragrafi 1 nënparagrafet 51 dhe 72, Nenit 5, Nenit 33 paragrafi 4 nënparagrafi 4.1, Nenit 37, Nenit 38 dhe Nenit 62 paragrafi 7 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085); Nenin 6 par. 1 të Rregullës Nr. 15/2017 për Vendosjen e të Hyrave të Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU); Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në lëndën P.A.nr.18/2025 të dt. 05.11.2025, Vendimin V_2994_2025 të datës 18 dhjetor 2025, Nenit 17 të Licencës për Furnizim me energji elektrike lëshuar ndërmarrjes “KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY” (KESCO) J.S.C, me numër licence ZRRE/Tr_2014/Li_07/17, e datës 27.04.2017; dhe Raportin e Vlerësimit të Konkurrencës në Sektorin e Energjisë Elektrike në Kosovë përmes Indeksit HHI (Herfindahl–Hirschman Index) për vitin 2024-2025,

në seancën e mbajtur më 22 prill 2026 nxori këtë:

V E N D I M

PËR VENDOSJEN E OBLIGIMIT TË SHËRBIMIT PUBLIK

- I. I VENDOSJET të Licencuarit për Furnizim me Energji Elektrike “KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY” J.S.C (në tekstin në vijim: “KESCO”), Obligimi i Shërbimit Publik për furnizim me energji elektrike konsumatorëve që gëzojnë të drejtën e furnizimit në kuadër të Shërbimit Universal.
- II. Obligimi i Shërbimit Publik sipas dispozitivit nën pikën I. të këtij Vendimi, i vendoset për periudhën (2) vjeçare dhe zbatohet nga data **01 prill 2026** deri më datën **30 mars 2028**.
- III. Të drejtën e Furnizimit si Shërbim Universal e gëzojnë të gjithë konsumatorët familjar dhe ndërmarrjet e vogla që i plotësojnë në mënyrë kumulative kriteret më pak se pesëdhjetë (50) punonjës dhe qarkullim vjetor ose bilanc total jo më shumë se dhjetë milion euro (10,000,000 €).
- IV. Pavarësisht dispozitivin nën pikën III. të këtij Vendimi, të gjithë konsumatorët fundor gëzojnë të drejtë për të zgjedhur furnizuesin e energjisë elektrike dhe për t’u furnizuar me energji elektrike në tregun konkurrues.
- V. Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejme: ZRRE) do të vazhdoj ti rregulloj çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve që gëzojnë të drejtën e furnizimit në kuadër të shërbimit universal, të cilat mbulojnë kostot e arsyeshme të furnizimit me energji elektrike.
- VI. Niveli i kostove për furnizim me energji elektrike dhe i çmimeve do të rishikohen në baza vjetore, në pajtim me Rregullën për Vendosjen e të Hyrave të Furnizuesit me Shërbim Universal.
- VII. Furnizuesi i ngarkuar me Obligimin e Shërbimit Publik, sipas këtij Vendimi obligohet që të:



- a. furnizojë me energji elektrike si shërbim publik sipas kushteve të përcaktuara me këtë Vendim, me licencë, si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi,
- b. informojë konsumatorët (blerësit) për të drejtat e tyre dhe kushtet e furnizimit në kuadër të shërbimit universal,
- c. furnizojë me energji elektrike të një cilësie të caktuar sipas Rregullës për Standardet e Cilësisë së Furnizimit dhe Shërbimit,
- d. faturojë energjinë elektrike të livruar në pajtim me çmimet e përcaktuara nga ZRRE, dhe
- e. publikojë tarifat në faqen e vet të internetit, së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para fillimit të aplikimit.

- VIII.** KESCO përmes këtij Vendimi obligohet të realizojë ndarjen e plotë ligjore, organizative dhe funksionale të aktivitetit të furnizimit në kuadër të shërbimit universal nga aktiviteti i furnizimit në tregun konkurrues, për shkak të nevojës për të garantuar funksionimin efektiv të tregut konkurrues dhe shmangien e shtrembërimit të konkurrencës.
- IX.** Ndarja ligjore, organizative dhe funksionale sipas pikës VIII të këtij Vendimi nënkupton themelimin e një subjekti juridik të veçantë për ushtrimin e njërit nga aktivitetet e furnizimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- X.** KESCO obligohet që ndarjen ligjore, organizative dhe funksionale ta realizojë brenda afatit prej gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi.
- XI.** Të gjitha kontratat ekzistuese për furnizim me energji elektrike për konsumatorët në tregun konkurrues transferohen në subjektin juridik të ri, pa ndërprerje të furnizimit dhe pa ndryshim të kushteve thelbësore kontraktuale.
- XII.** Transferimi i kontratave sipas pikës XI. të këtij Vendimi nuk cenon të drejtat e konsumatorëve dhe nuk kërkon ndërprerje apo ri-nënshkrim të detyrueshëm të kontratave ekzistuese, përveç nëse kërkohet nga legjislacioni në fuqi.
- XIII.** ZRRE do të mbikëqyrë procesin e ndarjes ligjore dhe mund të kërkojë masa shtesë për të garantuar zbatimin e këtij Vendimi.
- XIV.** Vendimi do të jetë pjesë përbërëse e Licencës për Furnizim me Energji Elektrike të lëshuar "KESCO"-së.

ARSYETIM

- o Zyra e Rregullatorit për Energji, bazuar në detyrat dhe funksionet e përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084 dhe Ligjin për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085, ka kompetencë dhe detyrim të monitorojë funksionimin e tregut të energjisë elektrike, të vlerësojë nivelin e konkurrencës dhe, kur është e nevojshme, të ndërmarrë masa proporcionale përmes vendosjes së obligimeve të shërbimit publik, me qëllim të garantimit të furnizimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së konsumatorëve dhe funksionimit efikas të tregut.
- o ZRRE në mënyrë të vazhdueshme ka vendosur dhe rishikuar Obligimin e Shërbimit Publik për Furnizuesin e Shërbimit Universal (KESCO), duke filluar nga viti 2017 dhe duke e vazhduar këtë



obligim në periudha të njëpasnjëshme, në funksion të sigurimit të furnizimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së konsumatorëve që gëzojnë këtë të drejt.

- Bazuar në Vlerësimin e konkurrencës në sektorin e energjisë elektrike për periudhën 2024–2025, ZRRE konstaton se tregu i energjisë elektrike në Republikën e Kosovës është i hapur dhe funksionon në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe me interpretimin e dhënë nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës. Në të njëjtën kohë, analiza e indikatorëve të konkurrencës tregon se struktura aktuale e tregut kërkon zhvillimin e konkurrencës efektive.
- Ky konstatim nuk cenon hapjen ligjore të tregut dhe të drejtën e konsumatorëve për të zgjedhur furnizuesin, por reflekton fazën aktuale të zhvillimit të tregut dhe nevojën për masa të përkohshme dhe proporcionale, për konsumatorët familjar dhe ndërmarrjet e vogla që i plotësojnë në mënyrë kumulative, sipas dispozitivit III të këtij Vendimi, të drejtën për furnizim nga Furnizuesi me Shërbim Universal dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- ZRRE, në ushtrimin e kompetencave të saj, ndërmerr masa rregullative vetëm në masën e nevojshme dhe proporcionale për të garantuar mbrojtjen e konsumatorëve dhe funksionimin e qëndrueshëm dhe efikas të tregut të energjisë elektrike. Në këto rrethana, vendosja e Obligimit të Shërbimit Publik mbetet masë e nevojshme dhe proporcionale, e cila synon sigurimin e furnizimit me energji elektrike për kategoritë e konsumatorëve që gëzojnë këtë të drejtë, duke garantuar çmime të arsyeshme, transparente dhe jo-diskriminuese.
- Në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në lëndën P.A.nr.18/2025, ZRRE është e obliguar të zbatojë interpretimin detyrues të Ligjit për Energjinë Elektrike, sipas të cilit e drejta për furnizim si shërbim universal u takon vetëm konsumatorëve familjar dhe ndërmarrjeve të vogla që i plotësojnë në mënyrë kumulative kriteret për numrin e punonjësve dhe qarkullimin vjetor. Ky Vendim reflekton këtë interpretim në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të plotë.
- ZRRE vlerëson se zhvillimi i mëtejshëm i tregut konkurrues kërkon ndërmarrjen e masave që sigurojnë ndarjen ligjore ndërmjet aktivitetit të rregulluar dhe aktivitetit konkurrues të Furnizuesit të Shërbimit Universal.
- ZRRE vlerëson se ndarja funksionale, organizative dhe kontabël ndërmjet aktivitetit të shërbimit universal dhe aktivitetit konkurrues përbën masë të përkohshme, e cila nuk është e mjaftueshme në rrethanat aktuale për të garantuar shmangien e shtrembërimit të konkurrencës.
- ZRRE vlerëson se duke marrë parasysh se aktivitetet e furnizimit në tregun e rregulluar dhe atë konkurrues ushtrohen nga i njëjti subjekt juridik, si dhe strukturën ekzistuese të tregut dhe lidhjet pronësore ndërmjet operatorëve të sektorit, ekziston rrezik i vazhdueshëm për shtrembërim të konkurrencës, përfshirë subvencionimin apo përdorimin e pozitës në tregun e rregulluar për avantazh në tregun konkurrues. Në këto rrethana, ndarja e plotë ligjore e aktiviteteve përbën masë të nevojshme, proporcionale dhe të arsyeshme për të garantuar neutralitetin e tregut, trajtimin e barabartë të të gjithë pjesëmarrësve dhe zhvillimin e konkurrencës efektive.



- ZRRE vlerëson se transferimi i kontratave ekzistuese të furnizimit në tregun konkurrues nga KESCO i rregulluar në subjektin juridik të ri është i domosdoshëm për të siguruar vazhdimësinë e furnizimit dhe stabilitetin e marrëdhënieve kontraktuale, pa cenuar të drejtat e konsumatorëve dhe pa krijuar pasiguri juridike.
- ZRRE vlerëson se kjo qasje është në përputhje me parimet e legjislacionit të Bashkimit Evropian, si dhe praktikën e vendeve të Komunitetit të Energjisë, ku ndarja ligjore e aktiviteteve zbatohet në rastet kur masat më të buta nuk janë të mjaftueshme për të garantuar konkurrencën efektive.
- Zbatimi i Obligimit të Shërbimit Publik dhe masave të lidhura me të, përfshirë ndarjen e aktiviteteve, nuk duhet të çojë në shtrembërim të konkurrencës dhe kufizohet vetëm në atë masë sa është e nevojshme për arritjen e qëllimeve të interesit publik, në përputhje me parimet e proporcionalitetit, transparencës dhe jo-diskriminimit.
- Bordi i ZRRE-së, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura, nivelin e zhvillimit të tregut të energjisë elektrike, nevojën për mbrojtjen e konsumatorëve që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe funksionimin efektiv të tregut konkurrues, si dhe detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi dhe aktgjykimet e formës së prerë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

XV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


XVI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, Anëtare


Gani Buçaj, Anëtar


Arta Isufi, Anëtare


Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi i dërgohet:

KESCO,
KEDS,
KOSTT-it dhe
Aktivit të ZRRE-së.